

**AKT THEMELIMI**  
**Per krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**"TOP Retail" Sh.p.k.**



Sot ne daten 06/02/2024 zoti **Agim FEZOLLARI** i biri i **Bajram** i datëlindjes 05/01/1987, me Nr.Personal: I70105084Q, lindur ne Preston Australia dhe banues në Pogradec me adrese Rruga e "Drilonit", Nd.13, H.1, disponues i leternjoftimit me Nr.034701544, bazuar në Ligjin Nr.9901, date 14/04/2008, **Vendosi te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "TOP Retail" Sh.p.k si me poshte vijon :**

*Neni 1*

Personi fizik i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe te plote ne pajtim me legjislacionin shqiptar, krijoi Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar (SH.P.K) me emertimin **"TOP Retail" Sh.p.k.**

**Ortak i vetem i Shoqerise "TOP Retail" Sh.p.k eshte z. Agim FEZOLLARI.**

**Administrator i Shoqerise "TOP Retail" Sh.p.k eshte z. Agim FEZOLLARI, i cili emerohet ne kete detyre per nje periudhe pese vjeçare me te drejte rizgjedhje.**

Shoqeria ka te drejte te krijojë filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne çdo kohe qe do te çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

*Neni 2*

Shoqeria **"TOP Retail" Sh.p.k**, gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi.

**Selia e Shoqerise "TOP Retail" Sh.p.k, eshte ne: Tirane Rruga "5 Maji", Emerald Center Mall dhe Residence, Njesia Bashkiake Nr 4, Zona Kadastrale 82/10 Tirane Shqiperi.**

Statuti i shoqerise i bashkengjitet ketij akti themelimi dhe eshte pjese perberese e saj.

**Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "TOP Retail" Sh.p.k, Tirana, Albania.**

*Neni 3*

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

*Neni 4*

**Shoqeria "TOP Retail" Sh.p.k ka si objekt te veprimtarise ekonomike:**

- Import-eksport, shperndarja dhe tregëtimi me shumicë e pakicë i të gjithë artikujve, mallrave dhe lëndëve të para të të gjitha llojeve që nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar dhe ai ndërkombetar.



*Neni 5*

Kapitali themeltar i shoqerisë është 1000 (njemije) Leke. Kapitali është i perbere nga 1 (nje) kuotë, me vlerë nominale 1000 (njemije) Lekë, i shlyer dhe i nenshkruar teresisht nga ortakut, **Agim FEZOLLARI**.

*Neni 6*

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket ortakut te vetem te saj.

*Neni 7*

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaku i vetem nuk mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tij qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

*Neni 8*

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

*Neni 9*

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e shoqerise percaktohen ne statutin e saj.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Agim FEZOLLARI**





DATE 06/02/2024  
NR REP 470

### VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot më datë 06/02/2024 në Studion Noteriale të ndodhur në Rrugën e “Kavajës”, Tiranë, para meje noterit **Artan TRESKA**, u paraqit personalisht:

**Z.Agim FEZOLLARI** i biri i Bajram i datëlindjes 05/01/1987, me Nr.Personal: I70105084Q, lindur ne Preston Australia dhe banues në Pogradec me adrese Rruga e “Drilonit”, Nd.13, H.1, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identifikuar nga leternjoftimi me Nr.034701544.

Z.Agim FEZOLLARI deklaroi para meje noterit se Akti i Themelimit te mësipërm për krijimin e Shoqërisë “TOP Retail” Sh.p.k është sipas vullnetit të tij të lirë e të plotë dhe nenshkroi perpara meje noterit.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018“Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij para meje.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERI**  
**Artan TRESKA**

